



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

C.nr. 102/2019

GJYKATA THEMLORE PRISHTINË DEGA NË LIPJAN-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL, në përbërje prej gjykatesit Isa Gashi, me pjesmarrjen e procesmbajtës Makfirete Zhinipotoku, duke vendosur në çështjen juridiko-civile të paditëses B. K. e S. me seli në Prishtinë, kundër të paditurit N. A. nga fshati G. e U. K.Lipjan, për rimbursim dëmi, vlera e kontestit 589.00 euro, pa mbajtur seancë, me datën 28.09.2022 muarr këtë:

A K T G J Y K I M
PËR SHKAK TË PADEGJUESHMËRISË

I.APROVOHET kërkespadia e paditëses, B. K. e S. me seli në Prishtinë, si e BAZUAR, dhe OBLIGOHET i padituri N. A. nga fshati G. e U., që paditëses t’ia paguaj shumën prej 589.00 euro, në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit rrugor me datën 27.01.2016 në udhëkryqin e rrugës B.-S. të Lipjanit, me kamatë sipas shkallës së kamatës që e paguajnë bankat për mjete të deponuara në bankë më tepër se një vit pa destimin të caktuar, duke filluar nga 13.03.2019 e deri tek pagesa definitive, si dhe t’ia kompenzoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 20.00 euro, të gjitha këto mbrenda afatit prej 15 dite nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi, nën kërcnimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditsja, B. K. e S. me seli ne Prishtinë, në këtë gjykatë ka ushtru padi kundër të paditurit N. A. nga fshati G. e U., për rimbursimin e dëmit, duke theksuar se i padituri me datën 27.01.2016, rreth ores 08:10 min, në Lipjan, me automjetin “wb” me targa të regjistrimit *Numer*, ka shkaktuar aksident komunikacioni rrugor, me dëme materjale dhe jo materjale i ka shkaktuar të dëmtuarit Rr. P.. Meqense automjeti, me fajin e të cilit ngasës është shkaktuar aksidenti në komunikacion, nuk ka pasur sigurim valid nga autopërgjegjsia me ndonjëren nga kompanit Sigurimit të licencuara në Kosovë, paditsja ia ka kompenzuar të dëmtuarit Rr. P. dëmin në lartësi prej 589,00.-€, dhe konform dispozitave të ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjesia nr. 04/L-018, dhe ka kërkuar rimbursimin e të njëjtit dëm të kompenzuar. I ka propozuar gjykatës ta aprovoi në tërsi kërkespadin si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata, konform nenit 394 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (Ligji nr.03/1-006 për Procedurën Kontestimore) të paditurit me datën 16.04.2019 ia ka dërguar aktvendimin C.nr.102/2019, të dt. 15.04.2019 dhe padin me prova tjera të bashkangjitura padis, me të cilin e ka ftuar të paditurin që mbrenda afatit prej 15 ditësh nga dorzimi i këtij aktvendimi të ushtron përgjigje në padi.

Gjykata, nga fletëkthesa e cila gjendet në shkresa të lëndës, konstatoi se i padituri aktvendimin me ftesë për përgjigje në padi dhe padin prova tjera, i ka pranuar me datën 23.04.2019, ndërsa deri më tani nuk ka ushtruar përgjigje në padi, edhe pse ka kaluar koha më tepër se 15 ditë, e përcaktuar me nenin 395.1 të LPK-ës.

Meqense i padituri nuk ka ushtruar përgjigje në padi, brenda afatit ligjor, i është dorëzuar rregullisht aktvendimi për pergjegjeje në padi dhe padia me prova të tjera, bazueshmëria e kërkespadis del nga faktet e treguara në padi, si ujdija jashtë gjyqësore e lidhur në mes paditëses dhe të dëmtuarit Rr. P. me nr. 215/16, të dt. 13.04.2016, fletëtransferi bankar i datës 13.05.2016, raporti policorë nr. *Numer*, si dhe faktet në të cilat bazohet kërkespadia, nuk janë në kundërshtim me provat që i ka paraqitur paditësi, andaj gjykata gjeti se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga n.150.1 te LPK-ës, për marrjen e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmëris, për qka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është mbështetë në dispozitivin e nenit 452 par.1,2 dhe 3 te LPK-ës, duke pasur parasysh suksesin e paditësit në procedurë, dhe të paditurin e obligoi t'i kompenzoi shpenzimet e procedurës në shumë prej 20,00 euro, në emër të takës gjyqësore për padi.

Nga të theksuarat më lartë u vendosë si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

C.nr.102/2019, më dt.28.09.2020.

GJYKATËSI

Isa Gashi

UDHËZIM JURIDIK: kundër këtijë aktgjykimi pala e paknaqur ka të drejtë të ushtrojë ankesë, në afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit. Ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e cila ushtrohet nëpërmes të kësajë gjykate.